

Program edukativ i bazuar në projektin

# SI TË LUFTOJMË DEZINFORMATAT

Nga 11 deri më 19 janar, viti 2021 (14.00 - 15.30)

*“Ka dy mënyra për të luftuar. Si dhelpër dhe si luan në të njëjtën kohë.”*

Ju ftojme të merrni pjesë në programin edukativ të bazuar në projektin “Si të luftojmë dezinformatat”, i cili do të mbahet në katër sesione nga 11 deri më 19 janar 2021, nga ora 14.00 deri në ora 15.30. Përmes këtij trajnimi interaktiv, do të njoftoheni me mënyrat se si krijohen dezinformatat, si shpërndahen të njëjtat, dhe më e rëndësishmja, do të mësoni teknikat dhe mënyrat si t’u kundërviheni atyre përmes aktiviteteve konkrete dhe parandaluese siç janë:

- Verifikimi i fakteve
- Targetimi i audiencave
- Krijimi i rrëfimeve pozitive
- Ndërmarrja e hapave për mbrojtje të organizatës suaj nga sulmet destruktive dezinformuese



Programi udhëhiqet nga Elida Zylbeari, gazetare dhe redaktore me përvojë disavjeçare. Ajo është udhëheqëse e projekteve në Fondacionin Metamorfozis, të cilat kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit dhe përforsimin e mediave në Maqedoninë e Veriut.

Ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Komunikimit dhe ka magjistruar në drejtimin Diplomaci në UEJL në Maqedoni. Nga viti 2012, ajo është kryeredaktore e portalit informativ në gjuhën shqipe Portalb.mk. Ajo është kryeredaktore e versionit shqip të projektit për promovimin e shkathtësive mediatike elementare “Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike – CriThink”. Ka qenë anëtare e bordit në Këshillin e Etikës të Mediave në Maqedoni. Nga viti 2012 deri në vitin 2014 ishte kryeredaktore e projektit “Shërbim i verifikimit të fakteve në mediat në gjuhën shqipe”.

Nga viti 2009 është gazetare aktive, verifikuese e fakteve dhe trajnere. Merr pjesë si paneliste në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për çështjet që lidhen me lirinë e fjalës dhe medias, shkathtësitë mediatike, gazetarinë digjitale dhe hulumtuese, qeverisjen e mirë dhe transparencën.

## Për kë është ky trajnim?

Për gazetarë dhe studentë të gazetarisë të interesuar të mësojnë më shumë rreth mënyrës si dezinformatat dëmtojnë një shoqëri dhe taktikat se si të luftohen ato. Për ata që janë të interesuar të bëhen verifikues të fakteve (fact-checkers). Gjithashtu për redaktorë ose pronarë të mediave të interesuar për të mbrojtur mediat dhe bizneset e tyre nga sulmet dezinformuese.

Si dhe për mësues, studiues dhe aktivistë të organizatave të ndryshme interesuar në fenomenin bashkëkohor të dezinformimit si dhe në mënyrat më efektive të luftës kundër tyre.

## Datat e trajnimit

Trajnimi përbëhet nga 4 sesione/punëtori të cilat do të mbahen online (përmes platformës Cisco WebEx).

- 11 janar 2021 nga ora 14 deri në ora 15.30 (e hënë)
- 13 janar 2021 nga ora 14 deri në ora 15.30 (e mërkurë)
- 15 janar 2021 nga ora 14 deri në ora 15.30 (e premte)
- 19 janar 2021 nga ora 14 deri në ora 15.30 (e martë)

## Formulari për aplikim dhe afatet

Për t'u regjistruar online në këtë trajnim, më së voni deri më 10 janar 2021 duhet të plotësoni formularin në këtë [link](#).

**Numri maksimal i pjesëmarrësve:** 15

**Gjuha e punës:** shqip dhe anglisht

Gjatë programit, pjesëmarrësit do të inkurajohen të krijojnë fushata reale për luftë kundër dezinformatave. Ideja më e mirë do të përkrahët financiarisht për implementim.

## Personi për kontakt

Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi kontaktoni me:

violetajonchevska@protonmail.com;  
qendresasulejmani@protonmail.com

## Kontrolloni [hive-mind.community](https://www.hive-mind.community)

Përveç këtij trajnimi, ju lutemi kontrolloni dhe portalin [www.hive-mind.community](https://www.hive-mind.community). Hive Mind është krijuar për ju që të ushtroni dhe të mësoni si t'i rrisni aftësitë e juaja digjitale mediatike në një mjedis bashkëpunimi me komunitetin tuaj të praktikës. Mjete të zgjedhura dhe të verifikuara, vegla jonë e krijuar posaçërisht për të ndjekur mediat sociale 'Social Media Radar' dhe kurse online të përshtatura sipas ritmit tuaj, janë disa nga mjetet që i gjeni në Hive Mind. Të gjitha gjenden në një mjedis të ruajtur dhe të sigurt.



**Ky trajnim është iniciativë e TechSoup Europe në bashkëpunim me Fondacionin “Metamorfozis” nga Maqedonia e veriut, organizatën “Zasto Ne” nga BH dhe HIVE MIND**



Metamorphosis Foundation works toward strengthening the awareness and capacity of citizens and civil society to assume their fullest possible role as activists for democracy, while supporting institutions to fulfil their democratic role in serving with particular emphasis on the use of information technology and knowledge-sharing.



CA Zasto ne - Why not is an organization that works on the creation of a safe, secure, healthy, active, efficient and accountable BiH society through increasing civic participation, influencing government accountability, use of new technology tools and promotion of socially engaged culture on the whole territory of BiH together with other interested groups, organizations, institutions and individuals.



TECHSOUP EUROPE supports civil society organizations across the continent to use the best technology for social change. It equips change makers with transformative technology products, knowledge, and services so they may benefit from technology and make social change. TechSoup teaches how to use technology for good and connects unlikely collaborators, such as social activists, hackers, designers, government, local authorities and business partners. TechSoup builds communities with whom it tries to generate innovative solutions to social challenges.



HIVE MIND — is a harbor for a community of practice. In today’s digital world, our freedom of information is being challenged by sophisticated misinformation and disinformation tactics. We’re here to assist you in the journey of digital transformation and to support these freedoms by building media literacy skills throughout civil society and in communities where people come together to form trust and social ties [www.hive-mind.community](http://www.hive-mind.community)